

**PLANI LOKAL
I TRANZICIONIT TË FËMIJËVE ROMË NGA ARSIMI PARASHKOLLOR NË
ARSIMIN FILLOR
DHE
ROLI I QENDRAVE KOMUNITARE**



Tiranë, 2026

Përmbajtja

Hyrje	3
Qëllimet e planit të tranzicionit.....	3
Objektivat e planit të tranzicionit.....	4
Rëndësia e kalimit të suksesshëm të fëmijëve nga kopshti në shkollë	4
Metodologjia e hartimit të planit.....	5
Koncepti i tranzicionit të suksesshëm.....	6
Parimet e tranzicionit gjithëpërfshirës	7
Kuadri ligjor dhe strategjik në Shqipëri.....	7
Dokumentet ndërkombëtare dhe praktikrat pozitive	8
Analiza e situatës	9
Roli i aktorëve në tranzicion	11
Prioritetet strategjike të planit të tranzicionit.....	13
Plani i veprimit.....	13
Integrimi i planit në planifikimin institucional	25
Mekanizmat e koordinimit.....	25
Monitorimi dhe raportimi	26
Indikatorët e zbatimit	27
Qëndrueshmëria e planit lokal të tranzicionit	27
Aneksë.....	28

Ky plan është hartuar në kuadër të projektit “*Roma Children Learn, Reducing Barriers for Education and Development*”, pjesë e programit rajonal “*EU Regional Action for Roma Education*”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe Roma Education Fund dhe zbatuar nga Save the Children në Shqipëri.

Hartimi i planit është realizuar nga:

Erida KOLECI

Eksperte në edukim



Hyrje

Kalimi nga arsimi parashkollor në arsimin fillor përbën një nga etapat më të rëndësishme në rrugëtimin arsimor të çdo fëmije. Një tranzicion i suksesshëm ndikon pozitivisht në mirëqenien emocionale, përshtatjen sociale, vazhdimësinë e të nxënës dhe rezultatet e mëvonshme në shkollë dhe në jetë. Përkundrazi, një tranzicion i paplanifikuar mund të rrisë rrezikun e vështirësive në përshtatjen me mjedisin e shkollës, frekuentimin e çrregullt në shkollë, arritjet e ulëta në mësim dhe, në raste të caktuara, braktisjen e hershme të shkollës.

Për fëmijët romë, ky proces shoqërohet shpesh me sfida shtesë që lidhen me kushtet socio-ekonomike, aksesin e kufizuar në shërbimet e zhvillimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme, pjesëmarrjen jo të plotë në arsimin parashkollor, barrierat kulturore, gjuhësore dhe institucionale, si dhe me nevojën për mbështetje më të madhe të familjeve gjatë kalimit në arsimin fillor. Për këtë arsye, krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore (*kopshte dhe shkolla*), strukturave vendore, qendrave komunitare dhe familjeve është një parakusht për garantimin e një tranzicioni të suksesshëm dhe gjithëpërfshirës.

Nisur nga nevoja për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve arsimore, strukturave vendore, qendrave komunitare dhe familjeve, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e praktikave që mbështesin tranzicionin e fëmijëve romë nga arsimi parashkollor në arsimin fillor, është hartuar ky *plan lokal i tranzicionit të fëmijëve romë nga arsimi parashkollor në arsimin fillor dhe roli i qendrave komunitare*

Plani është hartuar në kuadër të projektit “*Roma Children Learn, Reducing Barriers for Education and Development*”, pjesë e programit rajonal “*EU Regional Action for Roma Education*”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe Roma Education Fund, dhe zbatuar nga Save the Children në Shqipëri.

Qëllimet e planit të tranzicionit

Ky plan ka për qëllim të krijojë një kuadër të përbashkët veprimi për Bashkinë e Tiranës dhe Bashkinë e Gjirokastrës, institucionet e arsimit parashkollor dhe fillor, qendrat komunitare, familjet dhe aktorët e tjerë lokalë, për të mbështetur një tranzicion të suksesshëm, të barabartë dhe gjithëpërfshirës të fëmijëve romë nga arsimi parashkollor në arsimin fillor.

Gjithashtu, plani ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve arsimore dhe aktorëve lokalë, të orientojë planifikimin dhe zbatimin e masave të koordinuara për



tranzicionin, si dhe të mbështesë zhvillimin e mekanizmave të qëndrueshëm lokalë që sigurojnë vazhdimësinë e praktikave të suksesshme edhe pas përfundimit të projektit.

Plani mbështetet në parimin se tranzicioni nga arsimi parashkollor në arsimin fillor është një proces i përbashkët, i cili kërkon përgatitjen e fëmijëve për shkollë, përgatitjen e shkollës për të mirëpritur çdo fëmijë dhe angazhimin aktiv të prindërve, komunitetit dhe qendrave komunitare. Në këtë kuadër, ai ndërtohet mbi këta tre komponentë, duke i kushtuar një rol të veçantë qendrave komunitare si ura lidhëse ndërmjet familjes, institucioneve arsimore dhe shërbimeve vendore.

Objektivat e planit të tranzicionit

Plani ka këto objektiva:

- të analizojë situatën aktuale të tranzicionit të fëmijëve romë nga arsimi parashkollor në arsimin fillor në disa kopshte dhe shkolla në Tiranë dhe në Gjirokastrë, duke evidentuar arritjet, sfidat dhe nevojat për ndërhyrje;
- të forcojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet institucioneve të arsimit parashkollor dhe fillor, qendrave komunitare, familjeve dhe aktorëve të tjerë lokalë në mbështetje të tranzicionit;
- të mbështesë zhvillimin dhe zbatimin e praktikave që përgatisin fëmijët për fillimin e arsimit fillor, duke garantuar një tranzicion të sigurt, të vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës;
- të promovojë krijimin e mjediseve shkollore mikpritëse dhe gjithëpërfshirëse, të afta për t'iu përgjigjur nevojave dhe diversitetit të të gjithë fëmijëve, veçanërisht fëmijëve romë;
- të fuqizojë rolin e prindërve, familjes dhe komunitetit në mbështetjen e tranzicionit të fëmijëve nga arsimi parashkollor në arsimin fillor;
- të forcojë rolin e qendrave komunitare si mekanizma mbështetës për koordinimin ndërmjet familjes dhe institucioneve arsimore (*kopshte dhe shkolla*), me qëllim lehtësimin e tranzicionit dhe adresimin në kohë të vështirësive që mund të hasin fëmijët dhe familjet e tyre;
- të ofrojë rekomandime dhe masa konkrete për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e praktikave të tranzicionit në nivel vendor, duke siguruar qëndrueshmërinë e tyre në përputhje me politikat kombëtare për arsimin gjithëpërfshirës.

Rëndësia e kalimit të suksesshëm të fëmijëve nga kopshti në shkollë

Një tranzicion i suksesshëm nga arsimi parashkollor në arsimin fillor krijon kushtet që fëmijët të vazhdojnë zhvillimin dhe procesin e të nxënies në mënyrë të pandërprerë, duke u përshtatur

me kërkesat e mjedisit të ri shkollor. Përvoja e viteve të para të shkollimit ndikon në mirëqenien emocionale dhe sociale të fëmijës, në ndjenjën e përkatësisë ndaj shkollës, në motivimin për të nxënë dhe në rezultatet e tij të mëvonshme arsimore.

Studimet ndërkombëtare tregojnë se tranzicionet e planifikuara dhe të mbështetura mirë ruajnë përfitimet e arsimit parashkollor, përmirësojnë gatishmërinë për shkollë dhe krijojnë baza më të forta për suksesin në shkollë dhe zhvillimin social. Përkundrazi, mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve, përgatitja e pamjaftueshme e fëmijëve dhe familjeve, si edhe mjediset shkollore jo mjaftueshëm gjithëpërfshirëse, mund të ndikojnë negativisht në përshtatjen e fëmijëve dhe të rrisin rrezikun e vështirësive në akses dhe në të nxënë.

Këto sfida janë më të theksuara për fëmijët romë, të cilët shpesh përballen me pengesa që lidhen me kushtet socio-ekonomike, pjesëmarrjen jo të plotë në arsimin parashkollor, aksesin e kufizuar në shërbime mbështetëse dhe komunikimin e pamjaftueshëm ndërmjet familjes dhe institucioneve arsimore. Për këtë arsye, tranzicioni duhet të trajtohet si një proces i planifikuar, i koordinuar dhe gjithëpërfshirës, që synon të garantojë mundësi të barabarta për çdo fëmijë.

Metodologjia e hartimit të planit

Ky plan është hartuar mbi bazën e një procesi konsultues dhe të mbështetur në të dhëna, i cili ka kombinuar analizën e dokumenteve strategjike dhe legislative me konsultimet dhe vizitat në terren në bashkitë Tiranë dhe Gjirokastrë.

Procesi i hartimit të planit përfshiu:

- analizën e legjislacionit dhe të dokumenteve strategjike kombëtare në fushën e arsimit parauniversitar, arsimit gjithëpërfshirës dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;
- analizën e dokumenteve të Save the Children për tranzicionin e butë të fëmijëve nga arsimi parashkollor në arsimin fillor, të cilat shërbyen si dokumente referuese për ndërtimin e rekomandimeve të planit;
- vizita në institucionet e arsimit parashkollor dhe fillor, në qendrat komunitare dhe takime me përfaqësues të bashkive në Tiranë dhe në Gjirokastrë;
- konsultime me drejtues institucionesh, , mësues, psikologë, punonjës socialë, ndërmjetës romë, përfaqësues të qendrave komunitare dhe aktorë të tjerë lokalë, për të identifikuar praktikat ekzistuese, sfidat dhe nevojat që lidhen me tranzicionin e fëmijëve romë nga arsimi parashkollor në arsimin fillor;
- analizën e informacionit të mbledhur dhe formulimin e prioriteteve, objektivave, masave dhe rekomandimeve të planit.



Gjetjet e analizës shërbyen si bazë për përcaktimin e prioritetëve strategjike, objektivave, masave dhe aktivitetëve të planit të veprimit.

Faza	Veprimtaria	Rezultati
Analiza dokumentare	Legjislacioni, manuali, dokumentet e projektit	Kuadri teorik
Vizitat në terren	4 institucione arsimore, 2 qendra komunitare në 2 bashki (Tiranë dhe Gjirokastrë)	Evidenca në terren
Konsultimet	Drejtues, mësues, prindër, ndërmjetës komunitarë romë, staf psiko -social të qendrave komunitare, përfaqësues të shërbimit social të bashkisë	Gjetjet kryesore
Hartimi i planit	Analiza e të dhënave dhe formulimi i rekomandimeve	Plani lokal

Koncepti i tranzicionit të suksesshëm

Tranzicioni nga arsimi parashkollor në arsimin fillor është një proces i planifikuar dhe i vazhdueshëm, që mbështet kalimin e fëmijës nga një mjedis arsimor në tjetrin, duke garantuar vazhdimësinë e zhvillimit dhe të të nxëniet. Ai nuk kufizohet vetëm në regjistrimin në klasën e parë, por përfshin tërësinë e masave që ndërmerren para, gjatë dhe pas fillimit të shkollës.

Një tranzicion i suksesshëm mbështetet në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit parashkollor dhe fillor, familjes, autoriteteve vendore, qendrave komunitare dhe aktorëve të tjerë lokalë. Ky bashkëpunim krijon kushtet që fëmija të përshtatet me mjedisin e ri shkollor, të ndihet i mirëpritur dhe të zhvillojë më tej aftësitë njohëse, gjuhësore, sociale dhe emocionale. Ky plan mbështetet në tre komponentë themelore, të pandashëm nga njëri-tjetri:

- përgatitja e fëmijëve për shkollë;
- përgatitja e shkollës për të mirëpritur çdo fëmijë;
- angazhimi aktiv i prindërve, komunitetit dhe institucioneve përgjatë gjithë procesit të tranzicionit.

Për fëmijët romë, tranzicioni merr një rëndësi të veçantë, pasi ata mund të përballen me barriera që lidhen me kushtet socio-ekonomike, pjesëmarrjen e kufizuar në arsimin parashkollor, dygjuhësinë, mungesën e burimeve edukative në familje dhe aksesin e pamjaftueshëm në shërbime mbështetëse. Për këtë arsye, procesi duhet të planifikohet dhe të menaxhohet në mënyrë të koordinuar ndërmjet institucioneve arsimore, familjeve, shërbimeve sociale dhe aktorëve të tjerë lokalë, duke u shoqëruar me masa mbështetëse të përshtatura sipas nevojave të çdo fëmije.

Një tranzicion i planifikuar mirë lehtëson përshtatjen e fëmijëve me shkollën, rrit pjesëmarrjen dhe suksesin në të nxënë, ul rrezikun e braktisjes shkollore dhe kontribuon në garantimin e mundësive të barabarta për arsim cilësor dhe përfshirje sociale.

Parimet e tranzicionit gjithëpërfshirës

Ky plan mbështetet në parimet e arsimit gjithëpërfshirës dhe të interesit më të lartë të fëmijës, duke synuar që çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për të filluar dhe ndjekur me sukses arsimin fillor. Parimet mbi të cilat ndërtohet plani janë:

Interesi me në qendër fëmijën: Çdo masë dhe ndërhyrje duhet të ketë në qendër mirëqenien, zhvillimin dhe të drejtën e fëmijës për arsim cilësor.

Barazia dhe mosdiskriminimi: Të gjithë fëmijët, pavarësisht përkatësisë etnike, gjuhës, gjinisë, statusit social apo ekonomik, duhet të kenë akses të barabartë në arsimin parashkollor dhe fillor dhe të përfitojnë nga mbështetja e nevojshme gjatë tranzicionit.

Përfshirja dhe pjesëmarrja: Fëmijët dhe familjet e tyre duhet të jenë pjesë aktive e procesit të tranzicionit, ndërsa institucionet arsimore duhet të krijojnë mjedise mikpritëse, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse.

Bashkëpunimi ndërinstitutional: Tranzicioni i suksesshëm kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet kopshteve, shkollave, bashkive, Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, qendrave komunitare, shërbimeve sociale dhe organizatave partnere.

Vazhdimësia e të nxënit dhe zhvillimit: Procesi mësimor në arsimin fillor duhet të ndërtohet mbi përvojat dhe kompetencat që fëmijët kanë zhvilluar në arsimin parashkollor, duke siguruar një kalim të natyrshëm dhe të pandërprerë.

Vendimmarrja e bazuar në evidenca: Planifikimi dhe zbatimi i masave duhet të mbështeten në të dhëna, monitorim të vazhdueshëm dhe vlerësim të rezultateve, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të tranzicionit.

Zbatimi i këtyre parimeve krijon bazën për një tranzicion të suksesshëm dhe kontribuon në rritjen e pjesëmarrjes, përmirësimin e rezultateve të të nxënit dhe uljen e rrezikut të braktisjes së hershme të shkollës, veçanërisht për fëmijët romë dhe grupet e tjera në situatë vulnerabiliteti.

Kuadri ligjor dhe strategjik në Shqipëri

Hartimi i këtij plani mbështetet në kuadrin ligjor dhe strategjik në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në veçanti në:



- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila garanton të drejtën për arsim dhe parimin e mosdiskriminimit.
- Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton organizimin dhe funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar, të drejtën për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, si dhe përgjegjësitë e institucioneve arsimore.
- Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, i cili garanton interesin më të lartë të fëmijës, të drejtën për zhvillim, mbrojtje dhe pjesëmarrje.
- Ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës.
- Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, e cila promovon arsimin cilësor, gjithëpërfshirës dhe me mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët.
- Strategjinë Kombëtare për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025, e cila parashikon masa për rritjen e aksesit, pjesëmarrjes dhe suksesit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në sistemin arsimor.
- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, në pjesën që lidhet me zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe përfshirjen sociale.
- Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, e cila përcakton parimet e zhvillimit të kompetencave dhe vazhdimësinë ndërmjet niveleve të arsimit.
- Kurrikulën e Arsimit Parashkollor (korniza kurrikulare, standardet e të nxënës dhe të zhvillimit) dhe programet mësimore të arsimit fillor, të cilat mbështesin zhvillimin e gatishmërisë për shkollë dhe vazhdimësinë e të nxënës.

Dokumentet ndërkombëtare dhe praktikat pozitive

Ky plan mbështetet gjithashtu në dokumente dhe udhëzime ndërkombëtare që promovojnë të drejtën e çdo fëmije për arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe për një tranzicion të suksesshëm nga arsimi parashkollor në arsimin fillor, ndër të cilat:

- *Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (1989)*, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, e cila garanton të drejtën e çdo fëmije për arsim, zhvillim dhe mbrojtje.
- *Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Agenda 2030)*, veçanërisht *Objektivi 4 – Arsim Cilësor*, që synon sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës, të barabartë dhe cilësor për të gjithë.
- *UNESCO - Udhëzimet për Arsimin Gjithëpërfshirës*, të cilat promovojnë krijimin e sistemeve arsimore që u përgjigjen nevojave të të gjithë fëmijëve.



- *UNICEF - Transitions to Primary School* dhe dokumente të tjera udhëzuese mbi tranzicionin nga arsimi parashkollor në arsimin fillor, të cilat theksojnë rëndësinë e vazhdimësisë së të nxënës, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përfshirjes së familjes.
- *OECD - Starting Strong Series*, që evidenton rëndësinë e zhvillimit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme dhe ndikimin e tranzicionit të suksesshëm në rezultatet afatgjata të të nxënës.
- *Korniza Strategjike e Bashkimit Evropian për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve 2020-2030*, e cila promovon akses të barabartë në arsim dhe reduktimin e pabarazive për fëmijët romë.
- *UNESCO Salamanca Statement and Framework for Action on Special Needs Education (1994)*, që vendos parimet themelore të arsimit gjithëpërfshirës dhe të shkollës për të gjithë.
- *Materiale dhe dokumente të hartuar nga Save the Children*, të cilat përmbledhin praktika të mira dhe rekomandime konkrete për mbështetjen e tranzicionit nga arsimi parashkollor në arsimin fillor.

Praktikat pozitive ndërkombëtare

Praktikat ndërkombëtare tregojnë se tranzicioni është më i suksesshëm kur:

- sigurohet bashkëpunim i vazhdueshëm ndërmjet kopshtit dhe shkollës;
- organizohen vizita dhe aktivitete të përbashkëta për fëmijët para fillimit të klasës së parë;
- prindërit përfshihen në mënyrë aktive në përgatitjen e fëmijëve për shkollë;
- shkollat përshtasin mjedisin dhe procesin mësimor për të mirëpritur çdo fëmijë;
- komuniteti dhe strukturat mbështetëse, përfshirë qendrat komunitare, bashkëpunojnë me institucionet arsimore për të identifikuar dhe mbështetur fëmijët në rrezik.

Analiza e situatës

Analiza e situatës u mbështet në vizitat dhe konsultimet e zhvilluara me përfaqësues të disa institucioneve të arsimit parashkollor dhe fillor, qendrave komunitare, dhe aktorëve të tjerë lokalë në Bashkitë Tiranë (zona e Shkozës dhe e Lanabregasit) dhe në Gjirokastrë (lagjja Zinxhiraj). Gjetjet tregojnë se, megjithëse janë bërë përparime të rëndësishme në rritjen e aksesit të fëmijëve romë në arsimin parashkollor dhe fillor, procesi i tranzicionit vazhdon të përballet me sfida që kërkojnë ndërhyrje të koordinuar dhe të qëndrueshme.

Në të dyja bashkitë u evidentua se një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve romë ndjekin kopshtin dhe shkollën, ndërsa frekuentimi është përgjithësisht i rregullt për fëmijët që janë regjistruar. Megjithatë, vazhdojnë të ekzistojnë raste të mungesave të shpeshta, rrezikut për braktisje dhe lëvizjeve sezonale të familjeve (kryesisht në Greqi dhe në Kosovë), të cilat

ndikojnë në vazhdimësinë e procesit arsimor. Në disa raste, fëmijët nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor, duke e bërë më të vështirë përshtatjen e tyre në klasën e parë.

Nga konsultimet rezultoi se institucionet arsimore kanë zhvilluar praktika pozitive për mbështetjen e tranzicionit, si organizimi i vizitave të fëmijëve në shkollë, takimet ndërmjet mësuesve të kopshtit dhe mësuesve të klasës së parë, shkëmbimi i informacionit për gatishmërinë e fëmijëve, organizimi i aktiviteteve të përbashkëta. Këto praktika kontribuojnë në lehtësimin e kalimit nga kopshti në shkollë dhe krijojnë vazhdimësi në procesin e të nxënës. Megjithatë, analiza eidentoi një sërë sfidash që ndikojnë në cilësinë e tranzicionit. Faktorët socio-ekonomikë mbeten ndër pengesat kryesore, duke përfshirë varfërinë, punësimin sezonal të familjeve, lëvizjet migratore dhe mungesën e ndërgjegjësimi të disa prindërve për rëndësinë e arsimit parashkollor. Në disa komunitete, kushtet ekonomike ndikojnë drejtpërdrejt në frekuentimin e rregullt të kopshtit dhe shkollës, ndërsa nevoja për mbështetje materiale vazhdon të jetë e pranishme.

Në aspektin pedagogjik, u identifikuan vështirësi që lidhen me zhvillimin gjuhësor të një pjese të fëmijëve, veçanërisht atyre që nuk kanë ndjekur rregullisht kopshtin ose që rriten në mjedise dygjuhëshe. Edhe pse shumica e fëmijëve përshtaten mirë në aspektin social, mësuesit eidentuan nevojën për mbështetje shtesë në zhvillimin e aftësive gjuhësore, në lexim dhe shkrim gjatë vitit të parë të shkollimit.

Një gjetje e rëndësishme lidhet me bashkëpunimin ndërinstitucional. Ndërsa disa institucione kanë krijuar praktika të konsoliduara bashkëpunimi me bashkitë, Save the Children dhe organizata të tjera, bashkëpunimi ndërmjet shkollave, kopshteve dhe qendrave komunitare rezultojnë jo i njëjtë. Në disa raste ai funksionon mirë dhe mbështet regjistrimin, ndjekjen e fëmijëve dhe komunikimin me familjet, ndërsa në raste të tjera mungojnë mekanizmat e rregullt të koordinimit dhe të shkëmbimit të informacionit.

Roli i qendrave komunitare rezultojnë veçanërisht i rëndësishëm në mbështetjen e familjeve romë. Ato kontribuojnë në orientimin e prindërve për procedurat e regjistrimit, ndërmjetësimin me institucionet, zhvillimin e aktiviteteve edukative, mbështetjen e fëmijëve me aftësi bazë dhe organizimin e aktiviteteve komunitare. Megjithatë, potenciali i tyre nuk shfrytëzohet plotësisht për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, financiare dhe mekanizmave të formalizuara të bashkëpunimit me institucionet arsimore.

Nga konsultimet me drejtuesit dhe stafin pedagogjik u eidentuan gjithashtu nevoja për trajnime mbi arsimin gjithëpërfshirës kryesisht për punën me fëmijët romë, për forcimin e bashkëpunimit me prindërit, për rritjen e mbështetjes psiko-sociale dhe për krijimin e mekanizmave më të qëndrueshëm të monitorimit të tranzicionit.



Në tërësi, analiza tregon se ekzistojnë praktika të mira dhe një angazhim i konsiderueshëm i institucioneve vendore për mbështetjen e tranzicionit të fëmijëve romë. Megjithatë, për të garantuar një tranzicion të suksesshëm, të barabartë dhe gjithëpërfshirës, është e nevojshme të forcohet koordinimi ndërinstitutional, të institucionalizohet bashkëpunimi me qendrat komunitare dhe të sigurohen masa të qëndrueshme mbështetëse për fëmijët dhe familjet e tyre.

Roli i aktorëve në tranzicion

Tranzicioni i suksesshëm nga arsimit parashkollor në arsimin fillor kërkon angazhimin e koordinuar të institucioneve arsimore, autoriteteve vendore, familjes, qendrave komunitare dhe partnerëve të tjerë. Çdo aktor ka përgjegjësi të veçanta, por suksesi i procesit varet nga bashkëpunimi i tyre i vazhdueshëm dhe shkëmbimi i informacionit.

Bashkia

Bashkia luan një rol kyç në koordinimin e institucioneve dhe të shërbimeve vendore që mbështesin tranzicionin e fëmijëve romë. Në kuadër të këtij plani, bashkia ka përgjegjësi për:

- koordinimin e aktorëve lokalë që kontribuojnë në procesin e tranzicionit;
- mbështetjen e kopshteve, shkollave dhe qendrave komunitare në zbatimin e aktiviteteve të planit;
- garantimin e aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor, nëpërmjet shërbimeve sociale dhe mbështetjes së familjeve në nevojë;
- promovimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe monitorimin e zbatimit të planit në nivel vendor.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP)

ZVAP koordinon dhe mbështet institucionet arsimore në zbatimin e praktikave të tranzicionit, duke:

- orientuar dhe monitoruar bashkëpunimin ndërmjet kopshteve dhe shkollave;
- mbështetur shkëmbimin e informacionit mbi gatishmërinë e fëmijëve për shkollë;
- promovuar zhvillimin profesional të drejtuesve dhe mësuesve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës dhe tranzicionit;
- monitoruar frekuentimin dhe rastet në rrezik të braktisjes së shkollës.

Institucionet arsimore parashkollore- kopshtet

Institucionet e arsimit parashkollor kanë rolin kryesor në përgatitjen e fëmijëve për fillimin e arsimit fillor. Përgjegjësitë e tyre përfshijnë:



- zhvillimin e gatishmërisë për shkollë në të gjitha fushat e kurrikulës së arsimit parashkollor: Gjuhët dhe komunikimi; Matematikë; Shkencat e natyrës; Shkencat sociale; Arte; Edukim fizik, sporte dhe shëndet;
- vlerësimin e zhvillimit të fëmijëve dhe dokumentimin e progresit të tyre;
- bashkëpunimin me shkollat për shkëmbimin e informacionit mbi gatishmërinë e fëmijëve;
- organizimin e aktiviteteve që lehtësojnë njohjen e fëmijëve me mjedisin shkollor;
- bashkëpunimin me prindërit dhe qendrat komunitare për të mbështetur frekuentimin dhe përgatitjen e fëmijëve.

Shkollat

Shkollat kanë përgjegjësinë të krijojnë një mjedis mikpritës dhe gjithëpërfshirës për çdo fëmijë që fillon klasën e parë. Në këtë kuadër ato:

- organizojnë aktivitete orientuese për fëmijët dhe prindërit para fillimit të vitit shkollor;
- bashkëpunojnë me kopshtet për njohjen e fëmijëve dhe planifikimin e mbështetjes së nevojshme;
- identifikojnë dhe mbështesin fëmijët që hasin vështirësi në përshtatje ose në procesin e të nxënës;
- bashkëpunojnë me psikologun, punonjësin social dhe strukturat vendore për ndjekjen e rasteve në rrezik.

Qendrat komunitare

Qendrat komunitare përbëjnë një hallkë të rëndësishme lidhëse ndërmjet familjes, komunitetit dhe institucioneve arsimore. Roli i tyre përfshin:

- informimin dhe ndërgjegjësimin e familjeve për rëndësinë e arsimit parashkollor dhe fillor;
- mbështetjen e familjeve gjatë procedurave të regjistrimit dhe ndjekjes së arsimit;
- zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe mbështetëse për fëmijët;
- identifikimin dhe referimin e rasteve në rrezik te institucionet përgjegjëse;
- bashkëpunimin me kopshtet, shkollat, bashkinë dhe shërbimet sociale për mbështetjen e tranzicionit.

Familja dhe komuniteti

Familja është partneri kryesor i institucioneve arsimore në procesin e tranzicionit. Prindërit dhe kujdestarët kontribuojnë në:

- sigurimin e frekuentimit të rregullt të kopshtit dhe shkollës;
- mbështetjen e zhvillimit të fëmijës në mjedisin familjar;
- pjesëmarrjen në takimet dhe aktivitetet e organizuara nga institucionet arsimore;



- bashkëpunimin me mësuesit, edukatorët dhe qendrat komunitare për adresimin e vështirësive që mund të shfaqen gjatë tranzicionit.

Organizatat partnere

Organizatat partnere kontribuojnë në përmirësimin e tranzicionit përmes mbështetjes teknike dhe financiare, zhvillimit të programeve për fuqizimin e familjeve dhe komuniteteve, ofrimit të trajnimeve për profesionistët dhe promovimit të praktikave të mira në arsimin gjithëpërfshirës. Bashkëpunimi i tyre me institucionet vendore dhe arsimore ndihmon në krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm për mbështetjen e fëmijëve romë dhe familjeve të tyre.

Prioritetet strategjike të planit të tranzicionit

Prioriteti I: Përgatitja e fëmijëve për shkollë

Qëllimi: Të sigurohet gatishmëria e fëmijëve romë për fillimin e arsimit fillor, duke siguruar pjesëmarrje të rregullt në arsimin parashkollor, zhvillimin e kompetencave bazë dhe mbështetjen e individualizuar për fëmijët në rrezik.

Prioriteti II: Përgatitja e shkollës për fëmijët

Qëllimi: Të forcohet kapaciteti i shkollave për të garantuar një mjedis mikpritës, gjithëpërfshirës dhe mbështetës, që lehtëson tranzicionin dhe përshtatjen e suksesshme të fëmijëve romë në klasën e parë.

Prioriteti III: Angazhimi i prindërve dhe komunitetit

Qëllimi: Të rritet përfshirja aktive e prindërve, familjes dhe komunitetit në mbështetjen e tranzicionit të fëmijëve romë nga arsimi parashkollor në arsimin fillor, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me institucionet arsimore dhe strukturat vendore.

Prioriteti IV: Fuqizimi i rolit të qendrave komunitare

Qëllimi: Të forcohet roli i qendrave komunitare si struktura mbështetëse për koordinimin ndërmjet familjes, institucioneve arsimore dhe shërbimeve vendore, me synim garantimin e një tranzicioni të suksesshëm të fëmijëve romë nga arsimi parashkollor në arsimin fillor.

Plani i veprimit

Tabela e planit të veprimit:

PRIORITETI I: Përgatitja e fëmijëve për shkollë

Qëllimi: Sigurimi e gatishmërisë së fëmijëve romë për fillimin e arsimit fillor, duke siguruar pjesëmarrje të rregullt në arsimin parashkollor, zhvillimin e kompetencave bazë dhe mbështetje të individualizuar për fëmijët në rrezik.

Objektivi	Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Partnerët	Afati	Burimet	Treguesit
Rritja e gatishmërisë së fëmijëve për shkollë	Evidentimi i fëmijëve jashtë sistemit	Identifikimi dhe përditësimi çdo vit i listës së fëmijëve romë 3–6 vjeç që nuk frekuentojnë kopshtin.	Bashkia	NjMF, ZVAP, qendrat komunitare	Maj–Qershor	Burime njerëzore	Lista e përditësuar e fëmijëve jashtë sistemit.
		Kryerja e vizitave në familje për identifikimin e shkaqeve të mosfrekuentimit dhe hartimi i planit të referimit për secilin rast.	Qendrat komunitare	Bashkia, ndërmjetësit romë, NjMF	Maj–Korrik	Burime njerëzore	Numri i vizitave dhe i rasteve të referuara.
	Rritja e frekuentimit në arsimin parashkollor	Zhvillimi i seancave informuese për prindërit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor dhe regjistrimit në kohë.	Bashkia	Kopshtet, qendrat komunitare, OJF	Prill–Qershor	Materiale informuese (broshura, fletëpalosje)	Numri i seancave të zhvilluara dhe i prindërve pjesëmarrës.
		Mbështetja e familjeve për pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm dhe regjistrimin e fëmijëve në kopsht.	Bashkia	Qendrat komunitare, Zyrat e Gjendjes Civile, e-Albania	Qershor–Gusht	Burime njerëzore	Numri i fëmijëve të regjistruar me mbështetje.
	Përgatitja për klasën e parë	Veprimtari për zhvillimin e aftësive gjuhësore,	Kopshtet	Qendrat komunitare	Tetor–Qershor	Materiale didaktike	Numri i aktiviteteve të zhvilluara.

		njohëse, sociale dhe emocionale të fëmijëve.					
		Lexime dhe ritregime të përrallave e rrëfenjave nga tradita rome, të përshtatura për moshën e fëmijëve.	Kopshtet	Qendrat komunitare, prindërit	Tetor–Qershor	Libra me figura dhe materiale didaktike	Numri i veprimtarive të zhvilluara.
		Lojëra gjuhësore për njohjen me fjalë dhe shprehje të thjeshta në gjuhën rome (përshëndetjet, numrat, ngjyrat, emërtimet e anëtarëve të familjes etj.).	Kopshtet	Qendrat komunitare	Tetor–Qershor	Kartela, figura dhe materiale didaktike	Numri i veprimtarive të zhvilluara.
		Veprimtari muzikore dhe artistike me këngë për fëmijë nga tradita rome, të shoqëruara me vizatime, ngjyrosje etj.	Kopshtet	Qendrat komunitare	Tetor–Qershor	Materiale artistike dhe muzikore	Numri i veprimtarive të zhvilluara.
		Organizimi i vizitave të fëmijëve në shkollën ku do të regjistrohen dhe njohja me mjedisin, mësuesit dhe rutinat shkollore.	Kopshtet	Shkollat	Maj–Qershor	Burime ekzistuese	Numri i vizitave të organizuara.
	Mbështetje për fëmijët në rrezik	Organizimi i programeve mbështetëse për fëmijët që nuk kanë frekuentuar kopshtin ose kanë mangësi në aftësitë bazë para fillimit të klasës së parë.	Qendrat komunitare	Kopshtet, Bashkia	Qershor–Gusht	Buxheti vendor/projekte	Numri i fëmijëve të përfshirë në program.

	Monitorimi i tranzicionit	Hartimi i dosjes së tranzicionit për çdo fëmijë që kalon nga kopshti në klasën e parë, me informacion mbi zhvillimin dhe nevojat për mbështetje.	Kopshtet	Shkollat	Maj–Qershor	Format standarde	Përqindja e fëmijëve me dosje tranzicioni të plotësuar.
--	---------------------------	--	----------	----------	-------------	------------------	---

PRIORITETI II: Përgatitja e shkollës për fëmijët

Objektivi strategjik: Të rritet kapaciteti i shkollave për të garantuar një mjedis mikpritës, gjithëpërfshirës dhe mbështetës, që lehtëson tranzicionin dhe përshtatjen e suksesshme të fëmijëve romë në klasën e parë.

Objektivi	Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Partnerët	Afati	Burimet	Treguesit
Rritja e kapaciteteve të shkollës për një tranzicion të suksesshëm	Forcimi i bashkëpunimit kopsht–shkollë	Vizita të mësuesve të klasës së parë në kopsht për njohjen me fëmijët dhe mjedisin e të nxënësve.	Shkollat	Kopshtet	Prill–Maj	Burime njerëzore	Numri i vizitave të zhvilluara.
		Takime pune ndërmjet mësuesve të kopshtit dhe mësuesve të klasës së parë për shkëmbimin e informacionit mbi zhvillimin dhe nevojat e fëmijëve.	Shkollat	Kopshtet	Tetor dhe Maj	Burime njerëzore	Numri i takimeve të zhvilluara.
		Veprimtari të përbashkëta ndërmjet fëmijëve të kopshtit dhe nxënësve të klasës së parë me recitime, rrëfime	Shkollat	Kopshtet	Maj	Materiale didaktike	Numri i veprimtarive të zhvilluara.

		përrallash, këngë dhe lojëra nga kultura rome.					
		Ekspozita të përbashkëta me punimet e fëmijëve të kopshtit dhe të klasës së parë mbi kulturën dhe traditat rome.	Shkollat	Kopshtet	Maj	Materiale artistike	Numri i ekspozitave të realizuara.
	Krijimi i një mjedisi mikpritës	Ditë të hapura dhe veprimtari orientuese për fëmijët dhe prindërit para fillimit të vitit shkollor.	Shkollat	Kopshtet	Maj–Qershor	Materiale promocionale	Numri i aktiviteteve të realizuara.
		Përshtatja e klasave të para me materiale dhe kënde mësimore që lehtësojnë përshtatjen e fëmijëve.	Shkollat	Bashkia	Gusht–Shtator	Buxheti i shkollës/Bashkisë	Numri i klasave të pajisura.
		Pasurimi i këndeve të leximit me libra, përralla dhe materiale të ilustruara që pasqyrojnë historinë dhe kulturën rome.	Shkollat	Bibliotekat, qendrat komunitare	Shtator	Materiale didaktike	Numri i klasave të pajisura me materiale.
		Vendosja e materialeve informuese dhe vizuale që promovojnë respektin për diversitetin kulturor, përfshirë kulturën rome.	Shkollat	Bashkia	Shtator	Materiale informuese	Numri i klasave dhe mjediseve të pajisura.
	Zhvillimi profesional i stafit	Organizimi i të paktën një trajnimit në vit për mësuesit mbi tranzicionin, arsimin	ZVAP	ASCAP, Bashkia, partnerët	Gjatë vitit	Buxheti i trajnimeve	Numri i mësuesve të trajnuar.

		gjithëpërfshirës dhe punën me fëmijët romë.					
		Sesione pune për njohjen dhe përdorimin e materialeve mësimore mbi historinë, kulturën dhe gjuhën rome.	ZVAP	ASCAP	Gjatë vitit	Materiale trajnimi	Numri i sesioneve të zhvilluara.
		Shkëmbim përvojash ndërmjet mësuesve mbi praktikën gjithëpërfshirëse në punën me fëmijët romë.	ZVAP	Shkollat	Gjatë vitit	Burime njerëzore	Numri i sesioneve të shkëmbimit të përvojave.
		Veprimtari kushtuar 5 Nëntorit - Ditës Botërore të Gjuhës Rome.	Shkollat	ZVAP	Gjatë vitit	Materiale informuese dhe promovuese (UNESCO)	Numri i veprimtarive
	Mbështetja e fëmijëve në klasën e parë	Identifikimi i hershëm i fëmijëve që hasin vështirësi në përshtatje, frekuentim ose të nxënë dhe hartimi i planit të mbështetjes.	Shkollat	Psikologu, punonjësi social	Gjatë vitit	Burime njerëzore	Numri i planeve individuale të mbështetjes.
		Organizimi i takimeve mujore të ekipit psiko-social për ndjekjen e rasteve në rrezik.	Shkollat	Bashkia, NjMF	Gjatë vitit	Burime njerëzore	Numri i rasteve të trajtuara.
		Përdorimi i materialeve dygjuhëshe (shqip-gjuhë rome), kur është e nevojshme, për të mbështetur përshtatjen e	Shkollat	Qendrat komunitare	Gjatë vitit	Materiale didaktike	Numri i fëmijëve të mbështetur.

		fëmijëve romë në klasën e parë.					
	Monitorimi i tranzicionit	Monitorimi i frekuencimit dhe i ecures së fëmijëve romë gjatë vitit të parë të shkollimit.	Shkollat	ZVAP	Çdo 3 muaj	Burime njerëzore	Raportet e monitorimit të dorëzuara.
	Përmirësimi i praktikave	Organizimi i një takimi vjetor për analizimin e rezultateve të tranzicionit dhe identifikimin e masave për përmirësim.	ZVAP	Shkollat, kopshtet, Bashkia	Qershor	Burime njerëzore	Raporti vjetor i analizës së tranzicionit.

PRIORITETI III: Angazhimi i prindërve dhe i komunitetit

Objektivi strategjik: Të rritet përfshirja aktive e prindërve dhe komunitetit në mbështetjen e tranzicionit të fëmijëve romë nga arsimi parashkollor në arsimin fillor, nëpërmjet informimit, bashkëpunimit dhe mbështetjes së vazhdueshme.

Objektivi	Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Partnerët	Afati	Burimet	Treguesit
Rritja e angazhimit të prindërve dhe komunitetit në procesin e tranzicionit	Informimi i prindërve	Organizimi i të paktën dy sesioneve informuese në vit për prindërit e fëmijëve që kalojnë në klasën e parë.	Kopshtet	Shkollat, qendrat komunitare	Prill–Qershor	Burime njerëzore	Numri i sesioneve dhe i prindërve pjesëmarrës.
		Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese për rëndësinë e arsimit parashkollor, frekuencimit të rregullt dhe tranzicionit në klasën e parë.	Bashkia	ZVAP, qendrat komunitare	Gjatë vitit	Materiale informuese	Numri i materialeve të shpërndara.

		Sesione informuese për prindërit mbi historinë, kulturën, gjuhën dhe identitetin rom, si pjesë e mbështetjes së zhvillimit të fëmijëve.	Kopshtet	Qendrat komunitare, organizatat rome	Gjatë vitit	Materiale informuese	Numri i sesioneve të zhvilluara.
Bashkëpunimi shkollë–familje		Organizimi i takimeve individuale me prindërit e fëmijëve në rrezik për të hartuar masa mbështetëse.	Shkollat	Psikologu, punonjësi social	Gjatë vitit	Burime njerëzore	Numri i takimeve individuale.
		Organizimi i vizitave në familje për rastet me mungesa të shpeshta ose rrezik braktisjeje.	Bashkia	Qendrat komunitare, shkollat	Gjatë vitit	Burime njerëzore	Numri i vizitave të realizuara.
		Takime prindër–mësues për shkëmbimin e përvojave mbi ruajtjen e gjuhës amtare dhe identitetit kulturor të fëmijëve romë.	Kopshtet	Shkollat, qendrat komunitare	Gjatë vitit	Burime njerëzore	Numri i takimeve të zhvilluara.
Përfshirja e komunitetit		Organizimi i aktiviteteve komunitare me rastin e fillimit të vitit shkollor dhe ditëve ndërkombëtare kushtuar fëmijëve.	Bashkia	Shkollat, kopshtet, OJF	Gjatë vitit	Buxheti vendor/projekte	Numri i aktiviteteve të zhvilluara.
		Veprimtari komunitare me rastin e 8 Prillit – Ditës Ndërkombëtare të Romëve.	Bashkia	Shkollat, kopshtet, qendrat komunitare	Prill	Buxheti vendor/projekte	Numri i veprimtarive të zhvilluara.
		Veprimtari ndërgjegjëse për historinë e migrameve të	Bashkia	Shkollat, qendrat komunitare,	Gjatë vitit	Materiale informuese	Numri i veprimtarive të zhvilluara.

		romëve, kontributin e tyre në shoqëri dhe figurat e shquara në shkencë, art, politikë dhe sport me origjinë rome.		organizatat rome			
		Veprimtari përkujtimore me rastin e 2 Gushtit - Ditës Evropiane të Përkujtimit të Holokaustit ndaj Romëve.	Bashkia	Shkollat, qendrat komunitare	Gusht	Materiale informuese	Numri i veprimtarive të zhvilluara.
		Përfshirja e ndërmjetësve romë dhe komunitarë në identifikimin dhe referimin e fëmijëve jashtë sistemit arsimor.	Bashkia	Qendrat komunitare, NjMF	Gjatë vitit	Burime njerëzore	Numri i rasteve të identifikuar dhe të referuara.
Mbështetja e familjeve vulnerabël		Referimi i familjeve në shërbimet sociale, ekonomike dhe të mbështetjes së fëmijëve.	Bashkia	NjMF, qendrat komunitare	Gjatë vitit	Programet sociale	Numri i familjeve të referuara.
		Mbështetja e familjeve për sigurimin e materialeve bazë shkollore për fëmijët në nevojë në bashkëpunim me partnerët lokalë.	Bashkia	Organizatat partnere	Gusht–Shtator	Projekte/donatorë	Numri i fëmijëve të mbështetur.
Vlerësimi i bashkëpunimit		Zhvillimi i një ankete vjetore me prindërit për të vlerësuar nivelin e bashkëpunimit me institucionet arsimore dhe cilësinë e procesit të tranzicionit.	ZVAP	Shkollat, kopshtet	Qershor	Burime njerëzore	Raporti vjetor i rezultateve të anketës.

PRIORITETI IV: Fuqizimi i rolit të qendrave komunitare

Objektivi strategjik: Të forcohet roli i qendrave komunitare si struktura mbështetëse për koordinimin ndërmjet familjes, institucioneve arsimore dhe shërbimeve vendore, me qëllim garantimin e një tranzicioni të suksesshëm të fëmijëve romë nga arsimi parashkollor në arsimin fillor.

Objektivi	Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Partnerët	Afati	Burimet	Treguesit
Forcimi i rolit të qendrave komunitare në mbështetjen e tranzicionit	Formalizimi i bashkëpunimit ndërinstytucional	Hartimi dhe miratimi i një protokolli bashkëpunimi ndërmjet bashkisë, ZVAP-it, kopshteve, shkollave dhe qendrave komunitare për mbështetjen e tranzicionit.	Bashkia	ZVAP, qendrat komunitare	Brenda vitit të parë	Burime njerëzore	Protokolli i miratuar dhe në zbatim.
		Përcaktimi i personave përgjegjës për koordinimin e tranzicionit në çdo qendër komunitare.	Bashkia	Qendrat komunitare	Brenda vitit të parë	Burime njerëzore	Personat përgjegjës të emëruar.
	Zhvillimi i kapaciteteve	Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi me organizatat dhe përfaqësuesit e komunitetit rom për mbështetjen e veprimtarive edukative dhe kulturore.	Bashkia	Organizatat rome, qendrat komunitare	Brenda vitit të parë	Burime njerëzore	Numri i marrëveshjeve dhe partnerëve të përfshirë.
		Organizimi i të paktën një trajnimit në vit për stafin e qendrave komunitare mbi tranzicionin, arsimin gjithëpërfshirës dhe	Bashkia	ZVAP, ASCAP, organizatat partnere	Çdo vit	Buxheti i trajnimeve	Numri i specialistëve të trajnuar.

		bashkëpunimin ndërinstitucional.					
		Hartimi i një pakete standarde me materiale informuese dhe edukative për përdorim nga qendrat komunitare.	Bashkia	Organizatat partnere	Brenda vitit të parë	Projekte/Buxheti vendor	Paketa e materialeve e përgatitur dhe e shpërndarë.
		Pajisja e qendrave komunitare me materiale edukative mbi historinë, kulturën dhe gjuhën rome për përdorim me fëmijët dhe familjet.	Bashkia	ASCAP, organizatat partnere	Brenda vitit të parë	Projekte/Buxheti vendor	Numri i qendrave të pajisura me materiale.
	Zgjerimi i shërbimeve	Organizimi i programeve mbështetëse për zhvillimin e aftësive bazë të fëmijëve që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor.	Qendrat komunitare	Kopshtet, shkollat	Qershor–Gusht	Projekte/Buxheti vendor	Numri i programeve dhe i fëmijëve pjesëmarrës.
		Organizimi i aktiviteteve verore edukative dhe socializuese për fëmijët që do të fillojnë klasën e parë.	Qendrat komunitare	Bashkia, shkollat	Qershor–Gusht	Projekte/Donatorë	Numri i aktiviteteve dhe pjesëmarrësve.
		Organizimi i klubeve të leximit, tregimit dhe krijimtarisë me tema nga historia, kultura dhe tradita rome.	Qendrat komunitare	Bibliotekat, organizatat rome	Gjatë vitit	Materiale didaktike	Numri i klubeve dhe i pjesëmarrësve.
		Veprimtari kushtuar 5 Nëntorit - Ditës Botërore të Gjuhës Rome.	Qendrat komunitare	Bashkia, shkollat, organizatat rome	Prill / Gusht	Materiale informuese	Numri i veprimtarive të zhvilluara.

		Organizimi i veprimtarive ndërgjegjësuere me rastin e 8 Prillit dhe 2 Gushtit, në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe komunitetin rom.	Qendrat komunitare	Bashkia, shkollat, organizatat rome	Prill / Gusht	Materiale informuese	Numri i veprimtarive të zhvilluara.
	Monitorimi i tranzicionit	Krijimi i një regjistri të përbashkët për ndjekjen e fëmijëve romë gjatë procesit të tranzicionit.	Bashkia	ZVAP, qendrat komunitare	Brenda vitit të parë	Burime njerëzore	Regjistri funksional.
		Organizimi i takimeve gjashtëmujore për analizimin e rasteve në rrezik dhe koordinimin e ndërhyrjeve ndërmjet institucioneve.	Bashkia	ZVAP, shkollat, qendrat komunitare	Dy herë në vit	Burime njerëzore	Numri i takimeve dhe vendimeve të marra.
	Sigurimi i qëndrueshmërisë	Përfshirja e aktiviteteve të tranzicionit në planet vjetore të punës dhe buxhetet e bashkive dhe institucioneve partnere.	Bashkia	ZVAP, shkollat, qendrat komunitare	Çdo vit	Buxheti vendor	Numri i planeve institucionale që përfshijnë aktivitetet e tranzicionit.
		Organizimi i shfaqjeve artistike dhe muzikore që promovojnë kulturën rome.	Bashkia	Qendrat komunitare	Çdo vit	Buxheti vendor/Projekte	Numri i qendrave që zbatojnë programin vjetor.

Integrimi i planit në planifikimin institucional

Ky plan shërben si dokument orientues për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve që mbështesin tranzicionin e fëmijëve romë nga arsimi parashkollor në arsimin fillor. Aktivitetet e parashikuara në plan nuk zbatohen si veprimtari të veçuara, por integrohen në dokumentet e planifikimit të institucioneve përgjegjëse, në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë e secilit institucion.

Në fillim të çdo viti shkollor, çdo institucion analizon planin e veprimit dhe përzgjedh aktivitetet që lidhen me fushën e tij të përgjegjësisë. Këto aktivitete përfshihen në planet afatmesme dhe vjetore të institucionit, duke përcaktuar edhe afatet e realizimit, përgjegjësit, partnerët, burimet dhe treguesit përkatës.

Përfshirja e aktiviteteve në dokumentet e planifikimit institucional siguron që zbatimi i këtij plani të jetë pjesë e veprimtarisë së rregullt të institucioneve dhe garanton vazhdimësinë e masave edhe pas përfundimit të projekteve që mbështesin hartimin e tij.

Mekanizmat e koordinimit

Struktura koordinuese

Zbatimi i këtij plani kërkon edhe një mekanizëm të qëndrueshëm koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse në nivel vendor. Për këtë qëllim, në secilën bashki propozohet ngritja ose përcaktimi i një *Grupi Vendor për Tranzicionin*, i cili do të koordinojë planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të planit.

Grupi Vendor për Tranzicionin përbëhet nga përfaqësues të:

- Bashkisë;
- Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP);
- institucioneve të arsimit parashkollor;
- institucioneve të arsimit fillor;
- qendrave komunitare;
- Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës (NjMF);
- shërbimit psiko-social;
- ndërmjetësve romë;
- organizatave partnere që veprojnë në fushën e arsimit dhe përfshirjes sociale.

Grupi mbledhet të paktën *dy herë në vit*, si dhe sa herë që paraqiten problematika që kërkojnë ndërhyrje të koordinuar.

Roli i institucioneve përgjegjëse



Zbatimi i planit mbështetet në përgjegjësitë e ndara ndërmjet institucioneve.

Bashkia

- koordinon zbatimin e planit në nivel vendor;
- mbështet bashkëpunimin ndërinstitutional;
- siguron koordinimin me shërbimet sociale dhe NjMF;
- monitoron realizimin e aktiviteteve.

Kopshtet dhe shkollat

- zbatojnë aktivitetet e tranzicionit;
- bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacionit mbi fëmijët;
- monitorojnë përshtatjen dhe frekuentimin e nxënësve gjatë vitit të parë.

Qendrat komunitare

- mbështesin identifikimin dhe referimin e fëmijëve në rrezik;
- bashkëpunojnë me familjet dhe institucionet arsimore;
- ofrojnë aktivitete mbështetëse për fëmijët dhe prindërit.

Organizatat partnere

- ofrojnë asistencë teknike dhe profesionale;
- mbështesin zbatimin e aktiviteteve sipas programeve dhe burimeve të disponueshme.

Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi i planit synon të vlerësojë progresin e zbatimit të aktiviteteve, arritjen e objektivave dhe efektivitetin e masave të ndërmarra.

Procesi i monitorimit përfshin:

- monitorimin periodik të aktiviteteve të planifikuara;
- mbledhjen dhe analizimin e të dhënave nga institucionet përgjegjëse;
- identifikimin e vështirësive dhe marrjen e masave korrigjuese;
- dokumentimin dhe shpërndarjen e praktikave të mira.

Institucionet përgjegjëse raportojnë mbi ecurinë e aktiviteteve sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, ndërsa Bashkia harton një raport vjetor mbi zbatimin e planit, i cili i prezantohet Grupit Vendor për Tranzicionin.

Raporti duhet të përmbajë:

- progresin e aktiviteteve;
- nivelin e arritjes së treguesve;
- problematikat e evidentuara;
- rekomandimet për përmirësimin e zbatimit të planit.



Indikatorët e zbatimit

Për të vlerësuar progresin e zbatimit të planit do të monitorohen, ndër të tjera, këta tregues:

Akresi dhe pjesëmarrja

- Përqindja e fëmijëve romë të regjistruar në arsimin parashkollor.
- Përqindja e fëmijëve romë që kalojnë nga kopshti në klasën e parë.
- Përqindja e frekuentimit të rregullt në kopsht dhe klasën e parë.
- Numri i rasteve të identifikuara në rrezik të braktisjes.

Cilësia e tranzicionit

- Numri i aktiviteteve të tranzicionit të zhvilluara nga kopshtet dhe shkollat.
- Përqindja e institucioneve që zbatojnë planin vjetor të tranzicionit.
- Numri i vizitave të organizuara në shkolla për fëmijët e kopshteve.

Përfshirja e familjes dhe komunitetit

- Përqindja e prindërve pjesëmarrës në aktivitetet e tranzicionit.
- Numri i vizitave në familje.
- Numri i familjeve të mbështetura për regjistrimin e fëmijëve.
- Numri i aktiviteteve komunitare të organizuara.

Bashkëpunimi ndërinstitucional

- Numri i takimeve të Grupit Vendor për Tranzicionin.
- Numri i institucioneve pjesëmarrëse në mekanizmat e koordinimit.
- Numri i rasteve të referuara dhe të ndjekura në mënyrë ndërinstitucionale.
- Numri i raporteve periodike të monitorimit të hartuara.

Qëndrueshmëria e planit lokal të tranzicionit

Qëndrueshmëria e këtij plani mbështetet në angazhimin e institucioneve vendore dhe arsimore për të integruar masat e parashikuara në planifikimin dhe veprimtarinë e tyre të përditshme. Aktivitetet e planit synojnë të mos mbeten ndërhyrje të izoluara në kuadër të projektit, por të bëhen pjesë e praktikave të rregullta të bashkive, institucioneve arsimore dhe qendrave komunitare.

Për të siguruar vazhdimësinë e rezultateve, rekomandohet që:

- aktivitetet e planit të përfshihen në planet vjetore të punës të bashkive, ZVAP-eve, kopshteve, shkollave dhe qendrave komunitare;
- bashkëpunimi ndërinstitucional të formalizohet dhe të vazhdojë edhe pas përfundimit të projektit;



- të sigurohen burime financiare nga buxhetet vendore dhe programe të tjera mbështetëse për realizimin e aktiviteteve prioritare;
- të vazhdojë zhvillimi profesional i stafit dhe shkëmbimi i praktikave të mira;
- monitorimi i tranzicionit të bëhet pjesë e mekanizmave të zakonshëm të ndjekjes së institucioneve përgjegjëse.

Zbatimi i këtyre masave do të kontribuojë në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm lokal për mbështetjen e tranzicionit të fëmijëve romë nga arsimi parashkollor në arsimin fillor dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve përgjegjës.

Aneks

Aneks 1: Formular për shkëmbimin e informacionit ndërmjet kopshtit dhe shkollës për tranzicionin e fëmijës

Rubrika	Informacioni / Vlerësimi
Emri dhe mbiemri i fëmijës	
Data e lindjes	
Kopshti	
Shkolla	
Mësuesja e kopshtit	
Mësuesi/ja i/e klasës së parë	
Frekuentimi i rregullt i kopshtit	☐ Po ☐ Pjesërisht ☐ Jo
Komunikimi në gjuhën shqipe	☐ Po ☐ Pjesërisht ☐ Ka nevojë për mbështetje
Përshtatja me rregullat dhe rutinën	☐ Po ☐ Pjesërisht ☐ Ka nevojë për mbështetje
Marrëdhëniet me bashkëmoshatarët	☐ Të mira ☐ Mesatare ☐ Ka nevojë për mbështetje
Gatishmëria për klasën e parë	☐ E gatshme ☐ Pjesërisht e gatshme ☐ Ka nevojë për mbështetje



Mbështetja e rekomanduar	☐ Monitorim ☐ Mbështetje gjuhësore ☐ Takime me prindërit ☐ Psikolog/Punonjës social ☐ Qendra komunitare
Komente / Rekomandime	
Mësuesja e kopshtit	_____
Mësuesi/ja i/e klasës së parë	_____
Data	_____

ANEKSI 2

Lista e kontrollit për gatishmërinë e institucionit parashkollor për tranzicionin

Pyetja	Po	Pjesërisht	Jo	Komente
Janë identifikuar fëmijët që kalojnë në klasën e parë?				
Janë informuar prindërit për procedurat e regjistrimit?				
Janë zhvilluar takime me prindërit për tranzicionin?				
Janë organizuar vizita të fëmijëve në shkollë?				
Janë zhvilluar aktivitete të përbashkëta me shkollën?				
Është shkëmbyer informacioni me mësuesin e klasës së parë?				
Janë identifikuar fëmijët që kanë nevojë për mbështetje shtesë?				
Është bashkëpunuar me qendrën komunitare dhe institucionet vendore, sipas nevojës?				

ANEKSI 3

Lista e kontrollit për gatishmërinë e shkollës për tranzicionin e fëmijëve në klasën e parë

Pyetja	Po	Pjesërisht	Jo	Komente
Është hartuar plani vjetor i aktiviteteve të tranzicionit në bashkëpunim me kopshtin?				
Janë organizuar vizita orientuese të fëmijëve të kopshtit në shkollë?				



Janë organizuar ditë të hapura ose aktivitete njohëse për fëmijët dhe prindërit para fillimit të vitit shkollor?				
Është shkëmbyer informacion me mësueset e kopshtit për gatishmërinë dhe nevojat e fëmijëve?				
Janë identifikuar fëmijët që kanë nevojë për mbështetje shtesë në fillim të klasës së parë?				
Janë planifikuar masa mbështetëse për fëmijët në rrezik ose me vështirësi në përshtatje?				
Është bashkëpunuar me psikologun, punonjësin social dhe ekipin psiko-social të shkollës për mbështetjen e fëmijëve?				
Është krijuar një mjedis mikpritës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët e klasës së parë?				
Janë informuar dhe përfshirë prindërit në procesin e tranzicionit?				
Monitorohet frekuentimi dhe përshtatja e fëmijëve gjatë muajve të parë të shkollimit?				
Bashkëpunohet me qendrën komunitare dhe institucionet vendore për rastet që kërkojnë mbështetje?				
Janë dokumentuar rezultatet dhe sfidat e procesit të tranzicionit për përmirësimin e praktikave?				

ANEKSI 4: Instrumentet që u përdorën gjatë vizitave në terren

Qendra komunitare

Çështjet	Pyetje orientuese	Për plotësim	Evidenca
Identifikimi i fëmijëve dhe familjeve	Sa fëmijë romë ndjek qendra komunitare? Sa janë në kopsht dhe sa në shkollë?		
Frekuentimi i qendrës	Sa rregullisht e ndjekin qendrën? Kush mungon shpesh?		
Rastet në rrezik	Cilët fëmijë janë në rrezik braktisjeje ose mosregjistrimi?		
Roli i qendrës në tranzicion	Çfarë bën konkretisht qendra për kalimin nga kopshti në klasë të parë?		



Bashkëpunimi me kopshtin	Si bashkëpunon qendra me kopshtin?		
Bashkëpunimi me shkollën	Si bashkëpunon qendra me shkollën “Së Bashku”?		
Shkëmbimi i informacionit	A shkëmbehen të dhëna mbi frekuentimin dhe rastet në rrezik?		
Vizitat në familje	A realizohen vizita në familje? Në cilat raste?		
Ndihma për regjistrimin	A ndihmon qendra për dokumentacionin dhe regjistrimin?		
Aktivitetet përgatitore	A organizohen aktivitete përgatitore para klasës së parë?		
Vizitat në shkollë dhe kopësht	A organizohen vizita të përbashkëta për fëmijët dhe prindërit?		
Aktivitetet e përbashkëta	A zhvillohen aktivitete të përbashkëta me kopshtin dhe shkollën?		
Mbështetja pas shkolle	Çfarë mbështetjeje ofrohet pas mësimit?		
Mbështetja psikosociale	A ofrohet këshillim apo mbështetje emocionale?		
Bashkëpunimi me prindërit	Si punohet me familjet?		
Ndërgjegjësimi i familjeve	A e kuptojnë familjet rëndësinë e arsimit dhe frekuentimit?		
Vështirësitë kryesore	Cilat janë sfidat më të mëdha që has qendra?		
Kushtet ekonomike	Sa ndikojnë kushtet ekonomike te frekuentimi dhe tranzicioni?		
Nevojat e qendrës komunitare	Çfarë mbështetjeje i nevojitet qendrës?		
Bashkëpunimi ndërinstitutional	Me cilat institucione bashkëpunon qendra?		
Monitorimi i tranzicionit	A ndiqen fëmijët edhe pas regjistrimit në klasë të parë?		
Rastet e suksesit	A ka raste suksesi në tranzicionin e fëmijëve?		
Rastet problematike	Cilat janë rastet më problematike? Si zgjidhen?		



Shkollë

Çështjet	Pyetje orientuese	Për plotësim	Evidenca / të dhëna
Identifikimi i fëmijëve romë	Sa fëmijë romë dhe egjiptianë ndjekin shkollën “Së Bashku”? Sa janë në klasat fillore?		
Frekuentimi	Sa e ndjekin rregullisht shkollën? Kush mungon shpesh?		
Arsyet e mungesave	Pse mungojnë? Emigrim, kushte ekonomike, punë sezonale, mungesë mbështetjeje familjare?		
Braktisja	Sa e kanë braktisur shkollën? Sa janë në rrezik braktisjeje?		
Regjistrimi dhe dokumentacioni	A kanë dokumentacion të plotë? Kush i ndihmon familjet?		
Bashkëpunimi me kopshtin	A ka bashkëpunim mes shkollës dhe kopshtit për tranzicionin e fëmijëve?		
Vizitat në shkollë	A organizohen vizita të fëmijëve të kopshtit në ambientet e shkollës?		
Vizitat e mësuesve në kopsht	A shkojnë mësuesit e klasës së parë në kopsht për të njohur fëmijët?		
Aktivitetet e përbashkëta	A zhvillohen aktivitete të përbashkëta mes kopshtit dhe shkollës?		
Shkëmbimi i informacionit	A shkëmbehet informacion mbi gatishmërinë e fëmijëve për shkollë?		
Tranzicioni nga kopshti në klasë të parë	Si realizohet kalimi nga kopshti në shkollë?		
Roli i qendrës komunitare	Çfarë bën konkretisht qendra komunitare për fëmijët dhe familjet?		
Roli i qendrës komunitare në tranzicion	Si ndihmon qendra komunitare në lidhjen mes kopshtit dhe shkollës?		
Gatishmëria për shkollë	A janë fëmijët të përgatitur për rutinën shkollore?		
Përgatitja emocionale e fëmijëve	A zhvillohen aktivitete për të ulur ankthin dhe pasigurinë nga kalimi në shkollë?		



Zhvillimi gjuhësor	A flasin shqip? A kanë vështirësi në komunikim?		
Socializimi dhe integrimi	A integrohen me bashkëmoshatarët?		
Pjesëmarrja në klasë	A marrin pjesë aktivisht në mësim?		
Rezultatet në të nxënë	A kanë vështirësi në lexim, shkrim apo matematikë?		
Aftësitë socio-emocionale	Si reagojnë ndaj rregullave dhe rutinës?		
Mbështetja që jep shkolla	A ofrohen orë shtesë, psikolog, punonjës social, aktivitete pas shkolle?		
Vazhdimësia e mbështetjes pas regjistrimit	A ndiqen fëmijët edhe pas fillimit të klasës së parë?		
Bashkëpunimi me prindërit	Sa marrin pjesë prindërit? Si realizohet komunikimi?		
Përfshirja e prindërve në tranzicion	A organizohen takime të përbashkëta me prindërit për kalimin në klasë të parë?		
Ndërgjegjësimi i familjeve	A e kuptojnë familjet rëndësinë e shkollës?		
Kushtet ekonomike	A ndikojnë kushtet ekonomike në ndjekjen e shkollës?		
Nevojat e mësuesve	Çfarë mbështetjeje kërkojnë mësuesit?		
Mjedisi fizik i shkollës	A është shkolla gjithëpërfshirëse dhe e sigurt?		
Rastet e suksesit	A ka histori sukseesi të integrimit dhe vazhdimësisë në shkollë?		
Rastet problematike	Cilët fëmijë janë më në rrezik? Si mbështeten?		

Kopsht

Çështjet	Pyetje orientuese	Për plotësim	Evidenca / të dhënat
Identifikimi i fëmijëve romë	Sa fëmijë romë ndjekin kopshtin? Sa janë në moshë për klasë të parë?		
Frekuentimi	Sa e ndjekin rregullisht kopshtin? Kush mungon shpesh?		



Arsyet e mungesave	Pse mungojnë? Emigrim, varfëri, neglizhencë, lëvizje sezonale?		
Braktisje	Sa e kanë braktisur kopshtin? Sa janë në rrezik braktisjeje?		
Regjistrimi dhe dokumentacioni	A kanë dokumente? Kush ndihmon familjet?		
Roli i qendrës komunitare	Çfarë bën konkretisht qendra? Si bashkëpunon me kopshtin?		
Përgatitja për klasën e parë	Si përgatiten fëmijët për tranzicionin?		
Gatishmëria për shkollë	A njohin rutinat bazë? A qëndrojnë në grup?		
Zhvillimi gjuhësor	A flasin shqip? A kanë vështirësi komunikimi?		
Socializimi dhe integrimi	A integrohen me fëmijët e tjerë?		
Aftësitë socio-emocionale	Si reagojnë ndaj rregullave dhe rutinës?		
Bashkëpunimi me prindërit	Sa marrin pjesë prindërit?		
Ndërgjegjësimi i familjeve	A e kuptojnë rëndësinë e arsimit?		
Kushtet ekonomike	A ndikojnë kushtet ekonomike në ndjekjen e kopshtit?		
Nevojat e mësueset	Çfarë mbështetjeje kërkojnë mësueset?		
Mjedisi fizik i kopshtit	A është mjedisi i sigurt dhe gjithëpërfshirës?		
Bashkëpunimi ndërinstitutional	Me kë bashkëpunon kopshti? Si dhe me kë mund të bashkëpunohet?		
Rastet e suksesit	A ka histori sukcesi?		
Rastet problematike	Cilët fëmijë janë më në rrezik? Si mbështeten?		
Bashkëpunimi me shkollën	A ka bashkëpunim të rregullt me shkollën ku do të kalojnë fëmijët?		
Vizitat në shkollë	A organizohen vizita të fëmijëve në mjediset e shkollës?		
Takimet me mësuesit e klasës së parë	A zhvillohen takime mes mësueseve të kopshtit dhe mësuesve të klasës së parë?		



Aktivitetet e përbashkëta	A organizohen aktivitete të përbashkëta mes kopshtit dhe shkollës?		
Shkëmbimi i informacionit	A shkëmbehet informacion mbi gatishmërinë e fëmijëve për shkollë?		
Përgatitja e prindërve për tranzicionin	A organizohen takime me prindërit për kalimin në klasë të parë?		
Vazhdimësia e ndjekjes	A ndiqen fëmijët edhe pas kalimit në klasë të parë? Si?		